

|                                                                                   |                  |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|--------------|
|  | DOSJA E TENDERIT |        | F-085        |
|                                                                                   | Prishtinë        | v. 3.0 | Faqe 1 nga 4 |

## DOSJA E TENDERIT

Numri i referencës: 03/2026 KEC-MIL3

### Procedurë me Publikim – PMP

**Emri i kontratës: “Furnizim me produkte sanitare për nevojat e KEC dhe shkollës “Mileniumi i Tretë”**

**Data e shpalljes: 11.09.2026**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) njësia – Shkolla “Mileniumi i Tretë” fton ofertuesit e interesuar të dorëzojnë Ofertën e tyre për **“Furnizim me produkte sanitare për nevojat e KEC dhe shkollës Mileniumi i Tretë”** në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë Dosje të Tenderit.

### 1. Përshkrimi dhe Specifikimet Teknike

Objekt i këtij tenderi është **“Furnizim me produkte sanitare për nevojat e KEC dhe shkollës “Mileniumi i Tretë”**”

**Lista e produkteve, specifikimet teknike dhe sasi të parashikuara janë të përcaktuara në Listën e Specifikimeve Teknike dhe Çmimeve, ofertuesit mund ta kërkojnë atë përmes emailit:**  
[procurement@kec-ks.org](mailto:procurement@kec-ks.org).

**Kohëzgjatja e kontratës:** Kontrata do të ketë kohëzgjatje prej 1 (një) viti (Tetor 2026 – Tetor 2027), me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera, nëse dëshmohet performancë e mirë.

**Vendi i realizimit të kontratës dhe dorëzimit të mallrave është:** Qendra për Arsim e Kosovës, Kompleksi i shkollës “Milleniumi i tretë”, Rr. Qëndresa, Nr.48, Matičan.10 000 Prishtinë, Kosovë

**Afati i dorëzimit të mallrave:** Furnizimi i parë do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, sipas kërkesës së KEC/Shkollës “Mileniumi i Tretë”. Furnizimet e mëtejshme do të realizohen në bazë të porosive, të cilat mund të bëhen në baza ditore, javore ose mujore, varësisht nga nevojat dhe konsumi.

|  | DOSJA E TENDERIT |        | F-085        |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|--------------|
|                                                                                   | Prishtinë        | v. 3.0 | Faqe 2 nga 4 |

### Mostrat:

Ofertuesi duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull të ofruar, në përputhje me listën e specifikimeve. Mostrat duhet të vendosen në një pako të mbyllur dhe të dorëzohen së bashku me ofertën financiare.

Çdo mostër duhet të jetë e shënuar qartë me numrin rendor të artikullit, sipas numrit rendor përkatës në listën e specifikimeve të ofertës të cilat do të përdoren për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në këtë Dosje të Tenderit.

### Tërheqja e mostrave:

Mostrat e dorëzuara nga ofertuesit mund të tërhiqen pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe pas njoftimit për rezultatin e tenderit.

## 2. Dokumentet e kërkuara për Ofertim:

Ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Ofertën Financiare (Listën e plotësuar të Specifikimeve Teknike dhe Çmimeve), të nënshkruar dhe vulosur, duke përfshirë **çmimet për njësi në Euro (€), me TVSH** dhe duke përfshirë transportin e produkteve;
- Ofertat duhet të jenë **valide së paku 90 ditë** pas datës së dërgimit;
- Ofertuesi duhet të dorëzojë së bashku me ofertën, së paku **3 Referenca** për furnizime të ngjashme gjatë viteve të fundit, të lëshuara nga klientët/autoritetet përfitues;

## 3. Kushtet e Përgjithshme të Tenderit:

- Oferta duhet të përmbajë, për secilin artikull të përcaktuar në Listën e Specifikimeve Teknike dhe Çmimeve, të dhëna të plota dhe të qarta për produktin e ofruar, duke përfshirë brendin/prodhuesin, përmbajtjen ose madhësinë e paketimit/njesisë së produktit (p.sh. kg, g, L, ml, copë, etj.), sipas rastit, si dhe çmimin për njësinë përkatëse.
- Ofertuesi duhet të plotësojë të gjitha kolonat përkatëse në Listën e Specifikimeve Teknike dhe Çmimeve dhe të deklarojë saktësisht produktin që ofron për secilin artikull, në mënyrë që të mundësohet identifikimi dhe krahasimi i qartë i produkteve të ofertuara.
- Produkti i ofruar duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga KEC.
- Sasitë e paraqitura në Listën e Specifikimeve Teknike dhe Çmimeve përfaqësojnë sasi të parashikuara/mesatare vjetore.

|  | DOSJA E TENDERIT |        | F-085        |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|--------------|
|                                                                                   | Prishtinë        | v. 3.0 | Faqe 3 nga 4 |

- Sasitë reale të furnizuara mund të ndryshojnë gjatë periudhës së kontratës, në varësi të nevojave dhe kërkesave faktike të KEC-it dhe Shkollës “Mileniumi i Tretë”.
- KEC rezervon të drejtën të kërkojë sqarime shtesë nga ofertuesit gjatë procesit të vlerësimit.
- KEC rezervon të drejtën të refuzojë të gjitha ofertat dhe/ose të anulojë procedurën e tenderimit në çdo kohë, nëse ofertat nuk përmbushin kriteret e përcaktuara, specifikimet teknike ose në rast të pamjaftueshmërisë buxhetore, pa detyrim kompensimi.
- KEC nuk merr përgjegjësinë të kompensojë asnjë shpenzim që mund të bëhet nga kompanitë gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave.
- Ofertuesit do të njoftohen me shkrim për çdo ndryshim në specifikimet e përmbajtura në këtë Dosje të Tenderit;
- Gjatë vlerësimit të ofertave, nëse evidentohen gabime aritmetike, ato korrigjohen sipas këtyre rregullave: në rast dallimi mes shumëve në shifra dhe përshkrimin me fjalë, vlen përshkrimi me fjalë; në rast dallimi mes çmimit për njësi dhe totalit, vlen çmimi për njësi.
- Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Prokurimit të KEC, pas përfundimit të afatit për dorëzim.
- Vendimi përfundimtar, si rezultat i së cilës do të jetë kontrata, nuk do të bëhet përderisa nuk përfundojnë të gjitha procedurat e brendshme të KEC-it.
- Pagesa do të realizohet përmes transferit bankar në xhirollogarinë e specifikuar nga kontraktuesi, pas pranimit të Mallrave, sipas kushteve të kontratës dhe pas pranimit të faturës së rregullt. Pagesat në para të gatshme nuk do të realizohen.
- Ofertat të pa kompletuara me dokumentacionin e kërkuar nuk do të shqyrtohen.
- Çdo përpjekje për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në procesin e vlerësimit, vendimmarrjes ose përzgjedhjes do të konsiderohet shkelje e procesit të tenderimit dhe mund të rezultojë në përjashtimin e ofertës.

#### 4. Kriteret e vlerësimit:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mbështet vendimin e vet në ofertën që i posedon përparësitë më të larta ekonomike siç mund të jetë kualiteti i furnizimit, por kriteri bazë i vlerësimit është **çmimi më i ulët duke plotësuar specifikat e kërkuara**.

|                                                                                                                                                                       |                         |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|--------|--------------|
|  <b>KEC</b><br><small>Qendra për Arsim e Kosovës<br/>Kosova Education Center</small> | <b>DOSJA E TENDERIT</b> |        | <b>F-085</b> |
|                                                                                                                                                                       | Prishtinë               | v. 3.0 | Faqe 4 nga 4 |

## 5. Dorëzimi i Ofertave

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur deri më [25/09/2026], në ora 15:00, në adresën:

### Qendra për Arsim e Kosovës

Kompleksi i shkollës “Milleniumi i tretë”

Rr. Qëndresa, Nr.48, Matëçan.

10 000 Prishtinë, Kosovë

**Sqarim:** Qendra për Arsim e Kosovës punon me orar të punës të rregullt nga E hënë-E premte nga ora 08:00-16:00. Ju lutem gjatë aplikimit tuaj sigurohuni që ti dërgoni ofertat brenda këtij orari dhe gjatë ditëve të punës.

**Shënim:** Ofertat e dorëzuara pas afatit nuk pranohen. KEC nuk mban përgjegjësi për vonesa në dorëzim, pavarësisht mënyrës së dërgimit.

Ofertuesit mund të kërkojnë sqarime përmes emailit [procurement@kec-ks.org](mailto:procurement@kec-ks.org).

(Të plotësohet nga kompania)

|                             |  |
|-----------------------------|--|
| <b>Emri i kompanisë</b>     |  |
| <b>Numri i regjistrimit</b> |  |
| <b>Adresa</b>               |  |
| <b>Personi përgjegjës</b>   |  |
| <b>Telefoni</b>             |  |
| <b>E-maili</b>              |  |
| <b>Data e ofertimit</b>     |  |
| <b>Nënshkrimi dhe vula</b>  |  |
| <b>Validiteti i Ofertës</b> |  |